



KONTRATE SUPEVIZIMI

Per objektin „Rikonceptimi i sheshit para Bashkise Orikum”

Sot me date ___/___/2014 ne Orikum lidhet kjo kontrate per mbikqyrjen e punimeve te ndertimit per objektin „Rikonceptimi i sheshit para Bashkise Orikum“ (ketej e tutje referuar si kontrata)

Neni 1

Palet Kontraktuese

Bashkia Orikum me seli ne Orikum-Vlore e perfaqesuar ligjerisht nga Kryetari i Bashkise Z.Gezim CAPOJ (ketej e tutje referuar si Investitori) dhe shoqeria “M.A.K STUDIO” Sh.p.k perfaqesuar nga Ing.Tomor Spahiu, me license per mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi me nr : MK 1811/2 (ketej e tutje do te quhet mbikeqyres i punimeve).

Neni 2

Baza ligjore

Ligji nr.8652 date 31.07.2000 „Per organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore“, Ligji Nr 8402 dt 10.09.1998 „Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” Udhezimit te Keshillit te Ministrave Nr 3 dt 15.02.2001 „Per mbikeqyrjen e kolaudimin e punimeve te ndertimit“ ndryshuar me Nr 4 dt 17.05.2001 dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr 444 dt 05.09.1994

„Tarifat e studimit projektimit drejtimit dhe kolaudimit te veprave te ndertimit“ si dhe gjithë aktet e tjera ligjore te cilat nuk jane shprehur e cituar ne kete kontrate dhe Vendimit te Kryetari te Bashkise per emerimin e mbikeqyresit te punimeve

Neni 3

Objekti

Lidhet kontrata per caktimin e mbikeqyresit te punimeve te ndertimit per objektin :

„Rikonceptimi i sheshit para Bashkise Orikum“ midis Investitorit Bashkia Orikum e perfaqesuar nga Kryetari i saj njekoheisist Kryetar i Entit Prokurues Z. Gëzim ÇAPOJ dhe mbikeqyresit te punimeve “M.A.K STUDIO” Sh.p.k perfaqesuar nga Ing.Tomor Spahiu licensuar me license per mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi me nr : MK 1811/2 pasi u njoh me aktin e emerimit nga Kryetari i Bashkise Z.Gëzim ÇAPOJ me vullnet te lire pranon dhe merr persiper detyren e ngarkuar te mbikeqyresit te punimeve te ndertimit per objektin „Rikonceptimi i sheshit para Bashkise Orikum“ me punimet qe do te kryhen nga bashkimi i operatoreve ekonomik fitues te Tenderit “ Glavenica” sh.p.k & “Vllaznia”Sh.p.k perfaqesuar Z.Agim BARAJ me qender ne Fier



Neni 4

Cmimi i kontrates

Cmimi i kesaj kontrate fiksohet ne 21.000 (shtatembedhjete e peseqind) leke me T.V.SH

Neni 5

Te drejtat dhe detyrat e investitorit Bashkia Orikum

1. Te kerkoje ne cdo kohe informacion mbi bazen e akteve te perpiluara nga mbikeqyresi i punimeve sipas ecurise dhe fazave konkrete brenda grafikut te punimeve
2. Te zevendesoje mbikeqyresin e punimeve kur veren mangesi serioze ne punen e tij, duke bere zgjidhjen e njeanshme te kontrates i zhveshur nga cdo detyrim..
3. Te liroje e te dorezoje sheshin e ndertimit per punimet qe do te realizohen ne afatin e percaktuar ne kontraten e sipermarrjes.
4. Te vere ne dimeni mbikeqyresin per te gjitha ndryshimet qe mund te pasoje dokumentacioni teknik si dhe te gjitha dokumentacionin e nevojshem te kerkuar nga mbikeqyresi i p punimeve
5. Te beje pagesen e plote te mbikeqyresit ne baze te V.K:M. Nr 444 dt 05.09.1994 ne rastin konkret per shumen prej 17.500 (shtatembedhjete e peseqind) leke pa T.V.SH te percaktuar ne kete kontrate dhe sipas situacioneve te dorezuara.
6. Te informohet ne menyre te vazhdueshme nga ana e mbikqyresit te punimeve per ecurin e punimeve dhe problematikat konkrete.

Neni 6

Te drejtat dhe detyrimet e mbikeqyresit te punimeve

1. Te filloje pune pas dorezimit te sheshit tek sipermarresi
2. Te marre shperblim pas cdo situacioni te dorezuar tek sipermarresi
3. te kerkoje prej investitorit te gjitha dokumentacionin e nevojshem teknik qe ka lidhje me objektin ku punohet
4. Te mbaje konform udhezimit te V.K.M. Nr 3 dt 15.02.2001 te gjitha dokumentacionin e nevojshem dhe ta kete ate disponibel ne cdo moment qe i kerkohet investitorit.
5. Te kontrolloje librin e kantierit dhe eshte pòergjejes per vertetesine e dokumentacionit qe pasqyrohen atje.
6. Te verifikoje qe ne fillim te punimeve dokumentacionin teknik, licensen e sipermarresit (Firmes Fituese), verifikimin e sheshit te ndertimit njohjen e kontratave dhe pas verifikimit harton dokumentacionin perkates (pika 6 e Udhezimit Nr 3 dt 15.02.2001), e cila i bashkangjitet dosjes se tenderit
7. Te beje informim me shkrim cdo 15 dite per te gjitha rastet dhe masat e marra per zbatimin e projektit duke patur parasysh cinesine e materialeve dhe cinesine e punimeve te beje beje verifikimet ne rast difekte punimesh
8. Te mos lejoje asnje punim qe te realizohet (mbulohet, maskohet, betonohet) pa miratimin e tij duke i pasqyruar ne dokumentacionin perkates Ne rast te kundert duhet te marre inisiativen qe i lejon ligji per te rivendosur situaten teknike te pranuar nga ligji
9. Te kerkoje prej sipermarresit te gjitha aktet e nevojshme qe kane te bejne me perfundimin e punimeve kur se bashku me sipermarresin dhe kolaudatorin mbajne proces-verbalin per dorezimin e dosjes se punimimeve.



10. Kontrollon dhe miraton situacionet e paraqitura nga firma fituese dhe pas kesaj keto vleresohen te vlefshme per tu bere pagesa perkatese
11. Pas perfundimit te kolaudimit percakton vleren perfundimtare te objektit qe i jepet per likudim investitorit (Bashkise Orikum)
12. Te kerkoje prej Investitorit plotesimin e te gjitha kerkesave te parashikuar ne kontraten e sipermarrjes midis investitorit dhe sipermarresit qe lidhen me detyrimet e investitorit ndaj sipermarresit si dhe kontrollon dhe autorizon perdorimin e fondit rezerve.
13. Te ndjeke nga afer cdo punim qe behet prej sipermarresit ne objekt.
14. Te respektoje me perpikmeri dispozitat ligjore ne fushen e zbatimit te punimeve te ndertimit.

Neni 7 Sanksionet

Shkelja e nenit 5,6,7,8,9,10,11 te ligjit nr 8402 dt 10.09.1998 perben kundravajtje administrative dhe denohet me gjobe sipas ligjit.
Afati i gjobes eshte brenda 5 diteve pas kalimit te ketij afati paguhet kamate 2% vonese deri ne nje muaj.
Me vone vendimi egzekutohet ne rruge gjyqesore sipas ligjit ne Gjykatën e Shkalles se Pare rrethit Vlore
Palet pasi e lezojne kontraten dhe e gjejne ne perputhje me vullnetin e tyre te lire e neneshkruajen


Neni 8 Zgjidhja e mosmarreshjes

Ne rast mosmirekuptimi palet e perfshira ne ketekontrate i drejtohen gjykates se Shkalles se pare te rrethit Vlore.

Neni 9 Dispozitat

Kjo kontrate fiton fuqine e nevojshme juridike e detyruese pas neneshkrimit te saj prej palese pjesemarrrese
Kjo kontrata perpilohet ne pese kopje, nje kopje depozitohet prane protokoll arshives, nje kopje arshivohet ne ne dosjen e prokurimit, nje i vihet ne dispozicion Drejtorise se Finances, nje kopje i jepet sipermarresit te punimeve si dhe nje kopje i vihet ne dispozicion mbiqyresit te punimeve.

**INVESTITORI
BASHKIA ORIKUM
KRYETARI
Gezim CAPOJ**



**MBIKEYRESI I PUNIMEVE
"M.A.K STUDIO" Sh.p.k Nr lic. MK 1811/2
Perfaqsesi
Ing.Tomor Spahiu**

